


**Duke marrë parasysh të gjitha gjërat, a do të thonit se (vendi Juaj) do të kishte ose nuk do të kishte dobi nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian (tregun evropian)?**



Shënim: Tabela është marrë nga [http://ec.europa.eu/public\\_opinion/cf/index\\_en.cfm](http://ec.europa.eu/public_opinion/cf/index_en.cfm), dhe nga Sekretariati për çështje evropiane është bërë përmirësim i referencës së përkohshme dhe në të gjithë tekstin është shfrytëzuar emri kushtetues Republika e Maqedonisë.

Krahasuar me të njëjtin hulumtim dhe pyetjet e njëjta, por për periudhën 2012 - 2014, duke marrë parasysh opinionin publik në vendet kandidate për anëtarësim në BE, Republika e Maqedonisë në vazhdimësi dallohet për nivelin e lartë të mbështetjes për BE-në në krahasim me vendet e tjera kandidate të rajonit të shfaqura në grafiket të përpunuara nga SCE. Sipas hulumtimit të fundit të kryer në vjeshtë Republika e Maqedonisë sërisht tregoi rritje të nivelit të mbështetjes për BE-në, respektivisht 53% nga qytetarët mendojnë se anëtarësimi në BE është gjë e mirë, dhe ky rezultat është për dy pikë përqindjeje më i mirë në krahasim me hulumtimin e parafundit. Sipas statistikave, në vend të parë tanë është Republika e Shqipërisë e cila sapo fitoi statusin e vendit kandidat.

